



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 653/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lavdie Rrusta, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Lavdie Rrusta, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik NISMA, me shenjen ZL.Anr.653/2017 e datës 09.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Lavdie Rrusta, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në vendvotimet: 0320e/2D, 0224e/01R, 0326E/01D, 0301e/02R, dyshon se i mungojnë votat e disa personave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet nr. 0320e/2D, 0224e/01R, 0326E/01D, 0301e/02R, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku

parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.653/2017 me datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*